

UDHËZIM
Nr. 3, datë 31.3.2023

PËR CAKTIMIN E TARIFAVE TË VEPRIMTARISË DYTËSORE TË
PËRMBARUESIT GJYQËSOR PRIVAT PËR SHITJEN E SENDEVE NË ANKAND
PUBLIK

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 36, pika 2, të ligjit nr. 26/2019, “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”,

UDHËZOJ:

I. Objekti

1. Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i tarifave për kryerjen e shitjes së sendeve në ankand publik, me kërkesë të të interesuarve, nga përmbartuesit gjyqësorë privatë dhe i mënyrës së pagesës së tyre, kur ankandi zhvillohet në kuadër të veprimtarisë dytësore të përmbartuesit gjyqësor privat.

II. Fusha e zbatimit të udhëzimit

1. Ky udhëzim zbatohet vetëm në rastet e kryerjes së shitjes së sendeve në ankand publik si veprimtari dytësore e përmbartuesit gjyqësor privat, bazuar në kërkesën e personave fizikë dhe juridikë privatë, për shitjen në ankand të sendeve të cilat janë në pronësi të tyre.

2. Në rastin e sendeve të luajtshme të përdorimit të zakonshëm dhe që nuk kanë veçanërisht vlerë muzeale, numizmatike, koleksioni, artistike, pronësia e të cilave nuk mund të vërtetohet ndryshe, përmbartuesi gjyqësor privat pranon vetëdeklarimin për pronësinë e palës së interesuar mbi sendin, sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi, pjesë përbërëse e tij.

3. Ky udhëzim zbatohet edhe për procedurën e ankandit të sendeve, kur ato i nënshtrohen shitjes, sipas marrëveshjes së palëve për mbledhjen e detyrimeve financiare me mirëkuptim, si veprimtari dytësore e përmbartuesit gjyqësor privat.

III. Llojet e sendeve që i nënshtrohen tarifave të shërbimit për zhvillimin e ankandit

1. Ky udhëzim zbatohet për sendet e mëposhtme:

- a) sendet e çmueshme në pronësi të të interesuarit;
- b) sendet e paluajtshme në pronësi të të interesuarit ose në bashkëpronësi të tij;
- c) sendet e luajtshme në pronësi të të interesuarit, që nuk përjashtohen nga qarkullimi civil.

IV. Tarifa për kryerjen e shitjes së sendit në ankand publik

1. Shërbimi i shitjes së sendeve në ankand ofrohet nga përmbartuesi gjyqësor privat kundrejt pagesës së tarifave të përcaktuara në pikën 2 të këtij kreu.

2. Tarifa për kryerjen e shitjes së sendit në ankand publik përbëhet nga:

- a) tarifa e aplikimit në shumën 5 000 (pesë mijë) lekë;
- b) tarifa e zhvillimit të procedurës së ankandit, që mbulon publikimin e kërkesës në faqen elektronike të zhvillimit të ankandeve, kostot dhe shërbimin e përmbartuesit në shumën e 3 (tri) pagave minimale mujore;
- c) tarifa mbi vlerën e shitjes së sendit në ankand, që përcaktohet në varësi të sendit, si më poshtë:
 - i. për sendet e paluajtshme në pronësi të të interesuarit, në masën e 3% (tre për qind) të vlerës së shitjes së sendit;
 - ii. për sendet e çmueshme në pronësi të të interesuarit, në masën 10% (dhjetë për qind) të vlerës së shitjes së sendit;

iii. për sendet e luajtshme në pronësi të të interesuarit, që nuk përjashtohen nga qarkullimi civil, në masën e 5% (pesë për qind) të vlerës së shitjes së sendit.

3. Vlerës së tarifës së shërbimit, sipas pikës 2 të këtij kreu, në momentin e faturimit i shtohet TVSH-ja, sipas legjislacionit tatimor në fuqi.

V. Mënyra e pagimit të tarifës së shërbimit

1. Tarifat e përcaktuara në kreun IV të këtij udhëzimi paguhet nga pala e interesuar nëpërmjet sistemit bankar, në llogarinë e përmbaruesit gjyqësor privat për administrimin e aktivitetit tregtar si person fizik ose juridik.

2. Tarifa e shërbimit për aplikimin për shitjen e sendit në ankand paguhet nga i interesuari, pasi përmbaruesi gjyqësor privat ka pranuar lirisht kërkesën për shitjen e sendit në ankand publik.

3. Tarifa e shërbimit për aplikimin është e pakthyeshme, me përjashtim të rasteve kur vërtetohet nga i interesuari se publikimi i kërkesës në faqen elektronike të zhvillimit të ankandeve nuk është kryer.

4. Tarifa e zhvillimit të procedurës së ankandit është e pakthyeshme, pavarësisht rezultatit të procedurës së shitjes së sendit, në seancën e ankandit të zhvilluar për këtë qëllim. Seanca e ankandit përsëritet jo më shumë se dy herë për të njëjtin send, sipas marrëveshjes së parashikuar në kontratën tip që lidhet ndërmjet përmbaruesit gjyqësor privat me palën e interesuar, miratuar me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

5. Përmbaruesi gjyqësor privat transferon çmimin e sendit të shitur në ankand, sipas rastit, brenda 3 (tri) ditëve nga përfundimi i seancës së ankandit, në llogarinë e të interesuarit për pasuritë e luajtshme ose brenda 3 ditëve pas kalimit të pasurisë në emër të blerësit për rastin e sendeve të paluajtshme ose sendeve të luajtshme që regjistrohen në regjistrin publik. Për pagimin e tarifës mbi vlerën e shitjes së sendit, përmbaruesi gjyqësor privat mban në llogarinë e tij për administrimin e aktivitetit tregtar, si person fizik ose juridik, vlerën e përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 2, të kreut IV të këtij udhëzimi, përpara se të transferojë vlerën e çmimit të sendit të shitur në llogarinë e të interesuarit.

6. Përmbaruesi gjyqësor privat, pasi konstaton derdhjen e vlerës së sendit të shitur në ankand në llogarinë e të interesuarit, brenda 3 (tri) ditëve nxjerr vendimin për kalimin në pronësi të fituesit të sendit të blerë në ankandin publik, organizuar nga përmbaruesi gjyqësor privat dhe e depoziton në zyrën vendore kadastrale.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

SHTOJCA NR. 1 MODELI I VETËDEKLARIMIT

VETËDEKLARIM

**Për pronësinë e sendit që do t'i nënshtrohet shitjes në ankand publik,
nga përmbaruesi gjyqësor privat**

Unë i/e nënshkruari/a _____

(për individin jepen: emri, atësia, mbiemri, numri i dokumentit të identifikimit adresa, adresa elektronike, nr. llogarie bankare, nr. tel./fax /cel.; ndërsa për personin fizik/juridik privat jepen: emri, NUIS, adresa elektronike,

nr. i llogarisë bankare; selia, si dhe emri, atësia, mbiemri dhe numri i dokumentit të identifikimit të përfaqësuesit ligjor), sipas përcaktimeve të pikës 2 të kreut II të udhëzimit të ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e tarifave për veprimtarinë dytësore të përmbaruesit gjyqësor privat për shitjen e sendeve në ankand publik”, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë marrjen dijeni për ngarkimin me përgjegjësi penale për kryerjen e një deklarimi të rremë, sipas parashikimeve të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, se jam pronar i sendit

(përshkruben në mënyrë të detajuar të dhënat identifikuese të sendit dhe sipas rastit, dokumente provuese), që do të shitet në ankand publik nga përmbaruesi gjyqësor privat _____ (emri i përmbaruesit gjyqësor privat), me nr. licence _____, NUIS _____, adresë postare _____).

Nëpërmjet këtij vetëdeklarimi deklaroj, se:

1. I gjithë informacioni që i kam vënë në dispozicion përmbaruesit gjyqësor privat është i vërtetë dhe i saktë.

2. Jam i informuar se përbën shkelje në kuptim të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë:

a) dhënia e një informacioni/deklarimi të pasaktë/të pavërtetë;

b) paraqitja e dokumenteve të falsifikuara.

3. Deklaroj dhe pranoj se, nëse vërtetohet pasaktësia/falsiteti i një informacioni dhe/ose një dokumenti, ndaj meje mund të ndërmerren masat e nevojshme të përgjegjësisë civile dhe penale, për shkak të pasaktësisë/pavërtetësisë apo falsitetit të provuar.

4. Deklaroj dhe pranoj se të gjitha të dhënat e vëna në dispozicion nga unë, mund të verifikohen për efekt të saktësisë dhe vërtetësisë së tyre lidhur me aplikimin tim dhe se ky deklarim shërben si autorizim për përmbaruesin gjyqësor privat për të ndërmarrë çdo veprim, me qëllim verifikimin e të dhënave të këtij vetëdeklarimi, për qëllime të shitjes së sendit në ankand.

5. Deklaroj dhe pranoj se në vijim do të informoj mbi çdo informacion shtesë që do të ndryshojë statusin tim si pronar i sendit objekt shitje në ankand publik nga përmbaruesi gjyqësor privat.

VETËDEKLARUESI/PALA E INTERESUAR

Emri Mbiemri _____

Nënshkrimi _____

Data _____._____._____